# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 107

**Tiranë – E hënë, 8 qershor 2020**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 27.5.2020 | Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore | 6085 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 429, datë 3.6.2020 | Për një shtesë në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar | 6089 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 3.6.2020 | Për platformën qendrore të faturave | 6089 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 3.6.2020 | Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të pronës me emërtimin "tokë arë" | 6091 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 435, datë 3.6.2020 | Për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë "*Woodrow Wilson International*", ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhën angleze | 6097 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 436, datë 3.6.2020 | Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021–2022 e në vijim | 6097 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 437, datë 3.6.2020 | Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë | 6102 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 438, datë 3.6.2020 | Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të një sipërfaqeje të pasurisë me numër 35, zona kadastrale 1903, Bashkia Pogradec | 6103 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 439, datë 3.6.2020 | Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të një sipërfaqeje të pasurisë me numër 85/2, zona kadastrale 1553, Bashkia Maliq..... | 6106 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 440, datë 3.6.2020 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 410, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës..... | 6111 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 441, datë 3.6.2020 | Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e hartimit të projekteve për miratimin e lejeve të ndërtimit, për ndërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar, në bashkitë Durrës, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Shijak dhe Vorë..... | 6113 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 442, datë 3.6.2020 | Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese..... | 6113 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 445, datë 3.6.2020 | Për një shtesë në vendimin nr. 780, datë 6.11.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për caktimin e oficerëve koordinues, për çështjet e diasporës shqiptare, në konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi".... | 6115 |
| Urdhër i përbashkët i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 353, datë 29.5.2020 | Për miratimin e "Protokollit të masave anti-COVID-19 përgjatë sezonit turistik"..... | 6115 |

**VENDIM**
**Nr. 425, datë 27.5.2020**

**PËR PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË SUBJEKTEVE TË PAJISURA ME LICENCË PËR PROJEKTIM, ZBATIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM NË PASURITË KULTURORE, PËR KRYERJEN E INVESTIMEVE ME FONDE PUBLIKE NË PASURITË KULTURORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 90, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Investimet me fonde publike në pasuritë kulturore kryhen nga subjekte të licencuara për projektim, zbatim, mbikëqyrje ose kolaudim, në pasuritë kulturore, sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

2. Përzgjedhja e subjekteve për kryerjen e investimeve në pasuritë kulturore me fonde publike kryhet nëpërmjet konkurrimit publik, sipas procedurës së parashikuar në këtë vendim, nga:

a) ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;

b) institucionet e specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore;

c) institucione të tjera shtetërore.

3. Institucionet e përcaktuara në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 2, të këtij vendimi, kryejnë investime me fonde publike pas marrjes së autorizimit nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

II. PROCEDURA E KONKURRIMIT PUBLIK PËR PËRZGJEDHJEN E SUBJEKTEVE

1. Institucioni/autoriteti kontraktor, që disponon fondin publik për hartimin e projektit/ projekteve të zbatimit, të mbikëqyrjes dhe të kolaudimit në pasuri kulturore, fillon procedurat e konkurrimit publik, me urdhrin për ngritjen e Komisionit të Konkurrimit (në vijim "Komisioni").

2. Procedurat e konkurrimit kryhen nga Komisioni, i cili përbëhet nga kryetari dhe 5 (pesë) anëtarë, të cilët funksionojnë të ndarë në dy njësi, si më poshtë vijon:

a) njësia e hartimit të dokumenteve të konkurrimit publik;

b) njësia e vlerësimit të ofertave.

3. Njësia e hartimit të dokumenteve të konkurrimit publik përbëhet nga tre anëtarë, si më poshtë vijon:

a) një jurist;

b) një ekonomist;

c) një specialist i fushës së trashëgimisë kulturore.

4. Në njësinë e hartimit të dokumenteve të konkurrimit publik mund të caktohen specialistë nga institucione të specializuara të trashëgimisë kulturore.

5. Njësia e vlerësimit të ofertave përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë, specialistë të fushës së trashëgimisë kulturore. Kryetari i Komisionit përzgjidhet ndërmjet punonjësve me funksion drejtues të institucionit/autoritetit kontraktor që zhvillon procedurën.

6. Në njësinë e vlerësimit të ofertave, institucioni/autoriteti kontraktor, që kryen procedurën e konkurrimit publik, mund të kontraktojë ekspertë të jashtëm në rast të mungesës së personelit ose kur mungojnë njohuritë e specializuara në fushën ku kërkohet të zhvillohet procedura.

7. Juristi i Komisionit administron të gjithë dosjen e procedurës dhe asiston njësinë e vlerësimit të ofertave, pa të drejtë vote.

8. Anëtarët e Komisionit, në përmbushje të detyrës dhe të përgjegjësive të tyre, deklarojnë çdo rast të konfliktit të interesit, në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar.

9. Institucioni/autoriteti kontraktor, që zhvillon procedurën e konkurrimit, urdhëron hapjen e procedurës për zhvillimin e konkurrimit publik, që përmban:

a) të dhënat për pasurinë kulturore dhe kategorizimin e saj, sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë";

b) llojin e investimit/shërbimit përkatës;

c) fondin limit të parashikuar;

ç) përbërjen dhe emrat nominativë të anëtarëve të Komisionit;

d) pasaportën e pasurisë kulturore/monumentit të kulturës, të lëshuar nga Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK).

10. Njësia e hartimit të dokumenteve përgatit dokumentet e procedurës së konkurrimit publik, të cilat miratohen nga titullari i institucionit/autoritetit kontraktor dhe përmbajnë informacionin, si më poshtë vijon:

a) Njoftimin për konkurrimin publik;

b) Projektin e ndërhyrjes të miratuar nga KKTKM-ja dhe specifikimet teknike, me përjashtim të procedurës së konkurrimit për projektim;

c) Kriteret e ndërhyrjes dhe/ose termat e referencës;

ç) Preventivin me zërat e shërbimit/punimeve, vëllimet përkatëse, afatin, si dhe grafikun e kryerjes së tyre, me përjashtim të procedurës së konkurrimit për projektim;

d) Kriteret vlerësuese për përzgjedhjen e subjektit fitues;

dh) Dokumentacionin ligjor, financiar dhe teknik që duhet të paraqesin ofertuesit, sipas kritereve të përcaktuara në dokumentet e procedurës;

e) Datën, orën dhe vendin e hapjes së ofertave;

ë) Udhëzimet e nevojshme për ofertuesit;

f) Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

11. Dokumentet standarde të procedurës së konkurrimit publik miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe përdoren nga të gjitha institucionet/autoritetet kontraktore që realizojnë procedura konkurrimi, sipas këtij vendimi.

12. Njoftimi për konkurrimin publik përmban të dhënat, si më poshtë vijon:

a) institucionin që zhvillon konkurrimin publik;

b) emërtimin dhe vendndodhjen e objektit;

c) llojin e shërbimit/punës;

ç) fondin limit të procedurës së konkurrimit publik;

d) afatin e realizimit të shërbimit/punimeve;

dh) afatin dhe mënyrën për tërheqjen e dokumenteve të konkurrimit publik;

e) datën, orën dhe vendin e dorëzimit dhe të hapjes së ofertave;

ë) dokumentacionin që duhet të paraqesin ofertuesit.

13. Njoftimi për konkurrim publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen elektronike të institucionit/autoritetit kontraktor që zhvillon procedurën, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara dorëzimit të ofertave.

14. Kriteret për kualifikimin e subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore janë, si më poshtë vijon:

a) të jetë person fizik/juridik ose organizatë jofitimprurëse, e regjistruar në përputhje me legjislacionin shqiptar;

b) të ketë përmbushur detyrimet tatimore, pagesën e sigurimeve shoqërore;

c) të ketë përmbushur të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike;

ç) të mos jetë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;

d) të mos jetë në ndjekje penale ose i dënuar me një vendim të formës së prerë;

dh) të ketë përmbushur detyrimet për taksat vendore;

e) të provojë që ka aftësitë financiare për të realizuar projektin e propozuar, që institucioni vlerëson të nevojshme;

ë) të jetë i licencuar për projektim, zbatim, mbikëqyrje ose kolaudim, në pasuritë kulturore, sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore në varësi të objektit të konkurrimit;

f) të ketë përvojë të mëparshme në kryerjen e ndërhyrjeve ruajtëse të projektimit, të mbikëqyrjes dhe të kolaudimit në pasuritë kulturore;

g) çdo kriter tjetër teknik që provon aftësitë teknike për të realizuar shërbimet/punimet e kërkuara, në bazë të të dhënave të përcaktuara në dokumentacionin për konkurrim, që institucioni i vlerëson të nevojshme.

15. Subjektet e huaja lejohet të konkurrojnë vetëm në procedurat për hartim të projektit/projekteve të zbatimit, duke plotësuar kriteret, si më poshtë vijon:

a) të jenë të regjistruar në vendin e tyre për hartimin e projektit/projekteve të zbatimit, në pasuri kulturore;

b) të provojnë që kanë aftësi financiare për të realizuar objektin e procedurës së konkurrimit të shpallur nga institucioni;

c) të vërtetojnë me dokumentacionin përkatës që plotësojnë të gjitha kriteret e kërkuara në dokumentacionin e konkurrimit;

ç) të provojnë se kanë në stafin e tyre një projektues, i cili është i licencuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë".

16. Dokumentacioni i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i njësuar me origjinalin nga noteri.

17. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e procedurës. Në çdo rast, Komisioni duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit për përmbushjen e këtyre kritereve.

18. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e punimeve/shërbimit që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kriteret sipas parashikimeve në dokumentet e procedurës së konkurrimit.

19. Njësia e vlerësimit hap ofertat ekonomike në datën, vendin dhe orën e caktuar në njoftimin për konkurrim në prani të të gjithë ofertuesve të pranishëm. Kryetari lexon ofertat ekonomike të paraqitura nga ofertuesit dhe dokumentacionin shoqërues. Procesverbali i hapjes së ofertave firmoset nga të gjithë të pranishmit. Ofertat ekonomike nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së vlerësimit.

20. Subjekti, i cili nuk përmbush kriteret e përcaktuara në këtë vendim ose nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e procedurës së konkurrimit, shkualifikohet.

21. Procesi i vlerësimit vazhdon edhe kur është paraqitur vetëm një ofertë e vlefshme. Ofertë e vlefshme konsiderohet oferta që nuk mund të shkualifikohet, sipas parashikimeve të këtij vendimi.

22. Oferta fituese është oferta e vlefshme e kualifikuar me vlerën më të ulët ekonomike.

23. Njësia e vlerësimit shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e hapjes së ofertave. Procesi i vlerësimit dokumentohet në një procesverbal dhe nënshkruhet nga anëtarët. Pas përfundimit të shqyrtimit, titullari i institucionit që zhvillon procedurën, njofton në formë shkresore dhe me postë elektronike ofertuesit pjesëmarrës për renditjen dhe vlerësimin e secilit prej tyre.

24. Ankimi për procedurën e konkurrimit publik bëhet fillimisht te titullari i institucionit/autoritetit kontraktor që zhvillon procedurën, brenda 5 (pesë) ditëve nga e nesërmja e marrjes dijeni të vendimit. Në rastin kur ankimi nuk pranohet ose subjekti nuk merr përgjigje brenda afatit për ankesën e tij, ka të drejtë të bëjë ankim te ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, brenda afateve të përcaktuara në kreun III, të këtij vendimi.

25. Pas përfundimit të afatit të ankimit, nëse nuk ka pasur ankesa, sipas pikës 24, të këtij kreu, institucioni që zhvillon procedurën e konkurrimit njofton fituesin për lidhjen e kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi. Njoftimi i fituesit publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe përmban informacionin, si më poshtë vijon:

a) emrin e fituesit dhe adresën;

b) vlerën e ofertës fituese;

c) emrat e ofertuesve të tjerë pjesëmarrës dhe vlerat përkatëse të ofertave të tyre;

ç) afatin e lidhjes së kontratës;

d) sigurimin e kontratës që fituesi duhet të bëjë për llogari të institucionit që ka në dispozicion fondet publike, si garanci për përmbushjen e detyrimeve kontraktore.

III. SHQYRTIMI I ANKIMIT ADMINISTRATIV

1. Me paraqitjen e ankimit te titullari i institucionit/autoritetit kontraktor që zhvillon procedurën, sipas afatit të përcaktuar në pikën 24, të kreut II, të këtij vendimi, procedura pezullohet. Pas paraqitjes së ankimit, titullari i institucionit/autoritetit kontraktor që zhvillon procedurën, urdhëron ngritjen e një Komisioni, i cili shqyrton ankimin dhe merr vendim të arsyetuar brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e ankesës. Anëtarët që caktohen në Komisionin e shqyrtimit të ankimit, nuk duhet të kenë qenë pjesë e Komisionit të procedurës për të cilën bëhet ankimi.

2. Vendimi i njoftohet ankuesit jo më vonë se ditën vijuese të punës, në formë shkresore dhe në adresën elektronike të përcaktuar prej tij në formularin e ankesës.

3. Titullari i institucionit/autoriteti kontraktor që zhvillon procedurën vendos:

a) të mos pranojë ankimin;

b) të pranojë pjesërisht ankimin;

c) të pranojë plotësisht ankimin.

4. Në çdo rast, vendimi i titullarit të institucionit/autoritetit kontraktor është i arsyetuar.

5. Në rastin kur titullari i institucionit/autoritetit kontraktor që zhvillon procedurën nuk e pranon ankimin, e pranon pjesërisht atë ose nuk kthen përgjigje brenda afatit për shqyrtimin e ankesës, subjekti i interesuar ka të drejtë të ankohet te ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, brenda 5 (pesë) ditëve nga e nesërmja e marrjes dijeni të vendimit ose e përfundimit të afatit për të kthyer përgjigje nga titullari i institucionit/ autoritetit kontraktor. Një kopje e ankimit dorëzohet njëkohësisht edhe tek institucioni i cili zhvillon procedurën e kokurrimit publik.

6. Me paraqitjen e ankimit te ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, procedura mbetet e pezulluar deri në përfundimin e shqyrtimit të tij nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Brenda 3 (tri) ditëve nga e nesërmja e marrjes dijeni të ankimit, titullari i institucionit/autoritetit kontraktor përcjell dokumentacionin që vlerëson të nevojshëm për shqyrtimin e pretendimeve të ankuesit në ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore. Pas paraqitjes së ankimit, ministri urdhëron ngritjen e Komisionit, i cili shqyrton ankimin dhe i propozon ministrit pranimin ose mospranimin e ankimit. Shqyrtimi i ankimit përfundon brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e ankesës. Në rast se titullari i institucionit/autoritetit kontraktor nuk ka paraqitur informacionin e kërkuar ose e ka sjellë atë jo të plotë, ankimi shqyrtohet bazuar në informacionin që disponohet nga Komisioni i ngritur nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit, ministri, me urdhër, vendos:

a) të mos pranojë ankimin;

b) të pranojë pjesërisht ankimin;

c) të pranojë plotësisht ankimin.

7. Urdhri i ministrit për pranimin ose mospranimin e ankimit i njoftohet ankuesit dhe institucionit/autoritetit kontraktor jo më vonë se ditën vijuese të punës në formë shkresore dhe në adresën elektronike të përcaktuar prej tyre.

8. Urdhri i ministrit për pranimin ose mospranimin e ankimit mund të kundërshtohet në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon vazhdimin e procedurës.

9. Nëse ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore nuk shprehet me vendim brenda afatit të përcaktuar në pikën 6, të këtij kreu, afati për t'iu drejtuar gjykatës fillon nga e nesërmja e përfundimit të afatit për marrjen e vendimit nga ministri.

10. Në rastin kur përzgjedhja e subjekteve për kryerjen e investimeve me fonde publike kryhet nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, procedurat e ankimit zhvillohen sipas parashikimeve të pikave 1, 2 3, 4, 8 dhe 9, të këtij kreu.

IV. KONTRATA PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE/PUNIMEVE PËR NDËRHYRJET E DETYRUARA RUAJTËSE

1. Kontrata për realizimin e shërbimeve/ punimeve për ndërhyrjet e detyruara ruajtëse lidhet brenda 5 (pesë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, pasi është paraqitur edhe sigurimi i kontratës, në masën 10% të vlerës së ofertës fituese.

2. Kontrata përmban të dhëna, për:

a) përshkrimin e detajuar të pasurisë kulturore që është objekt i shërbimeve/punimeve për ndërhyrjet e detyruara ruajtëse dhe vendndodhjen e tij;

b) kategorizimin e pasurisë kulturore, në bazë të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë";

c) llojin e shërbimeve/punimeve;

ç) projektin e miratuar në KKTKM (në rastin e punimeve të zbatimit);

d) preventivin dhe grafikun e punimeve (në rastin e punimeve të zbatimit);

dh) çmimin e kontratës;

e) kohëzgjatjen e kontratës;

ë) garancinë e punimeve (në rastin e punimeve të zbatimit);

f) të drejtat dhe detyrimet e palëve;

g) kushte të tjera, të përcaktuara në dokumentet e procedurës.

3. Pas përfundimit të punimeve, kartelës së pasurisë kulturore, objekt i ndërhyrjes detyruese ruajtëse, i përditësohen të dhënat mbi ndërhyrjet e kryera dhe regjistrohen në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 216, datë 18.4.2007, i Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e konkurrimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara për

restaurimin e monumenteve të kulturës", i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, institucionet e specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore, si dhe institucionet publike që kanë në administrim pasuri kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 429, datë 3.6.2020**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës "C", të titulluar "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe AL-Qaida", shtohet individi i renditur në shkronjën "a", sipas shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për persona që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da'esh) dhe AL-Qaida".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-SË ("LISTA E OKB-SË")**

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (DA'ESH) DHE AL-QAIDA":

a) Lista e shtuar në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe AL-Qaida":

**Amir Muhammad Sa'id Abdal-Rahman al-Mawla**

Shënim: Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është renditur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

**VENDIM**
**Nr. 431, datë 3.6.2020**

**PËR PLATFORMËN QENDRORE TË FATURAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 26, të ligjit nr. 87/2019, "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton të drejtat dhe detyrimet e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (në vijim AKSHI) mbi lidhjen dhe paraqitjen e informacionit të lëshuesve dhe marrësve të faturave elektronike në platformën qendrore të faturave.

II. PËRKUFIZIME

Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

**2. "Platforma qendrore e faturave"**, sipas përcaktimit në shkronjën "i", të nenit 3, të ligjit nr. 87/2019, "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit".

**3. "SOAP *web services*"**, protokoll i bazuar në XML, që ka për qëllim shkëmbimin e informacionit të strukturuar, ndërmjet tatimpaguesit dhe administratës tatimore, nëpërmjet sistemeve kompjuterike.

**4. "Portali *Self-Care*"**, ndërfaqja e standardizuar për komunikim, ndërmjet tatimpaguesit dhe administratës tatimore, nëpërmjet rrjetit të sigurt për transferimin elektronik të të dhënave nëpërmjet internetit.

III. AUTORIZIMET DHE DETYRIMET GJATË PËRDORIMIT TË PLATFORMËS QENDRORE TË FATURAVE

5. AKSHI është i ngarkuar për krijimin, zhvillimin, mirëmbajtjen, administrimin dhe menaxhimin e platformës qendrore të faturave.

6. Lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike janë të detyruar të lidhen dhe të regjistrohen në platformën qendrore të faturave.

7. AKSHI, lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike, për qëllime të përdorimit të platformës qendrore të faturave, janë të detyruar të sigurojnë ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve thelbësore për rolin e tyre, në një mënyrë të besueshme dhe profesionale, në përputhje me dokumentacionin dhe specifikimet teknike të shkëmbimit të të dhënave, të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

8. AKSHI, lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike, për qëllime të përdorimit të platformës qendrore të faturave, janë të detyruar që, në ofrimin e shërbimeve dhe në komunikim ndërmjet tyre, të vënë në dispozicion të njëri-tjetrit informacionin përkatës që disponojnë, të respektojnë rregullat e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave, veçanërisht ato që mbrojnë të dhënat personale dhe përdorin procedurat dhe pajisjet e duhura teknologjike.

IV. ZBATIMI TEKNIK

9. AKSHI, lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike janë të detyruar të sigurojnë zbatimin e legjislacionit në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit dhe mirëmbajtjen e sistemeve të tyre të të dhënave.

10. AKSHI është i detyruar të sigurojë që shërbimet në fushën e platformës qendrore të faturave të jenë në përputhje me specifikimet e rregulluara teknike të shkëmbimit të të dhënave, të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

11. AKSHI, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të hartojë dhe të publikojë në faqet e tyre zyrtare të internetit specifikimet teknike të shkëmbimit të të dhënave, specifikimin bazë të përdorimit të faturave e dokumentacionet e tjera, si dhe çdo ndryshim të tyre.

V. LIDHJA ME PLATFORMËN QENDRORE TË FATURAVE

12. Aksesimi i platformës qendrore të faturave dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet AKSHI-t, lëshuesit dhe marrësit të faturave elektronike përmes platformës qendrore të faturave, do të jetë përmes shërbimeve të internetit të SOAP, duke përdorur mesazhe ose përmes portalit *Self-Care*.

13. Për qëllim të vendosjes së një lidhjeje me platformën qendrore të faturave, lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike janë të detyruar të përdorin dy mjedise të ndryshme, ku instalohen dhe shërbehen versione identike të platformës qendrore të faturave:

a) mjedisi provë/test – për qëllimet e trajnimit dhe të verifikimit të programeve; dhe

b) mjedisi i punës – për shkëmbimin zyrtar të të dhënave elektronike dhe informacionit.

AKSHI i siguron lëshuesve dhe marrësve të faturave elektronike mjediset e provës/testit dhe punës për platformën qendrore të faturave.

14. Kushtet për lidhjen e lëshuesve dhe të marrësve të faturave elektronike me mjedisin e punës të platformës qendrore të faturave janë:

a) kalimi me sukses i skenarëve të testit të detyrueshëm në mjedisin e provës/testit në platformën qendrore të faturave;

b) verifikimi i zgjidhjes *software*-ike.

Vetëm një version i verifikuar dhe i certifikuar i zgjidhjes *software*-ike mund të përdoret në mjedisin e punës. Zgjidhja *software*-ike e certifikuar një herë e lëshuesve dhe marrësve të faturave elektronike në mjedisin e provës/testit mund të përdoret për çdo lidhje të mëtejshme me platformën qendrore të faturave në mjedisin e punës.

c) regjistrimi i lëshuesve dhe marrësve të faturave elektronike në platformën qendrore të faturave.

15. Lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike janë të detyruar të përdorin certifikata elektronike të lëshuara nga AKSHI për t'u lidhur me platformën qendrore të faturave.

16. Certifikatat elektronike përdoren për të krijuar një lidhje të sigurt me platformën qendrore të faturave, për të identifikuar lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike kur shkëmbehen të dhënat në mënyrë elektronike, si dhe për nënshkrimin elektronik të mesazheve në komunikim, ndërmjet AKSHI-t, lëshuesit dhe marrësit të faturave elektronike. Certifikatat elektronike sigurojnë nëse lidhja është vendosur dhe është në përputhje me specifikimet teknike të shkëmbimit të të dhënave, të përmendura në pikën 11, të këtij vendimi.

17. Lëshuesit dhe marrësit e një fature elektronike që krijojnë lidhje me platformën qendrore të faturave në një mjedis prove/test dhe/ose pune janë të detyruar të zbatojnë specifikimet e duhura, në përputhje me specifikimet teknike të shkëmbimit të të dhënave, të përmendura në pikën 11, të këtij vendimi, të cilat rregullojnë mënyrën dhe kushtet e aksesimit (hyrjes) dhe të përdorimit të mjedisit të provës/testit dhe punës.

VI. ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIM

18. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**NR. 432, datë 3.6.2020**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, TË PRONËS ME EMËRTIMIN "TOKË ARË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja "c", të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të pronës me emërtimin "tokë arë", me sipërfaqe 37 300 $m^2$, sipas kartelës së pasurisë dhe planit të rilevimit bashkëlidhur, me institucion përdorues Qendrën Shumëfunksionale Kamzë.

2. Qëllimi i përdorimit të pronës nga institucioni përdorues është ofrimi i arsimit dhe formimi profesional.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra Shumëfunksionale Kamzë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**


Legend
Legjenda
School Development Area
Tot. Surface 37 300 m²
Zona e Zhvillimit te Shkolles
Siperf. Totale 37 300 m²
New and Old School Buildings
Godina e Re dhe Vjeter te Shkolles
Index
Indeks
Remarks
Shenime
Date
Data
FUND FOR VET AND EMPLOYMENT
HFC KARDA, ALBANIA
Consultant
Konsulent
SWECO - SymbiotiCA
Project Stage
Faza e Projektit
Development Plan
Plan Zhvillimi
Drawing Title
Emri i Vizatimit:
Area of School Development
Zona e Zhvillimit te Shkolles
No.
Nr.
Index
Indeks
Client: MoFE
Klient: KfW (Donor)
Beneficiary: HFC
Perfitues:
Local Engineers
Inxhinier Lokal
Date: 14.01.2020
Date:
Scale: 1:2000
Shkalla:

RILEVIM TOPOGRAFIK
BASHKIA KAMEZ
LEGJENDE

RILEVIM TOPOGRAFIK
BASHKIA KAMEZ
LEGJENDE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENSIA SHTETËRORE E KADASTRËS**
**DREJTORIA VENDORE E ASHK KAMEZ-VORE**

Nr. 7565/1 Prot Tiranë, më 08.10 2019

**Lënda : Kthim Përgjigje**

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE PUNËSIMIT**
**DREJTORIA E POLITIKAVE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL**

Në përgjigje të shkresës suaj me Nr.10920/3 Prot datë 30.9.2019 , protokolluar pranë zyrave tona me Nr.7565 Prot datë 01.10.2019, ju bejme me dije si me poshte:

Nga verifikimi i planit të rilevimit të përcjellë prej jush, objektet ë shkollës profesionale Kamëz , rezultojnë të jenë ndërtuar në pronën e cila prek në hartën tonë të zyrës pasurinë Nr.145/1 Z.K 2066 Vol.5 Fq.180 e llojit Arë me sipërfaqe 37300 e afishuar Shtet.

**Ju faleminderit për mirëkuptimin !**

**DREJTOR**
**ARION BISTRI**
**(Me urdhër me delegim)**
**ZV DREJTOR**
**INDRIT OSMANI**



KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol. 5 Fq. 120

Nr. i Kadastrale 2066 NR. i PASURISE 195/1

Adresa e pasurise TIRANE QK KAMEZ

PERSHKRIMI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Pasuria ARE

| Nga Sip. Totale sa Truall | Nga Sip. Truall sa Ndertuar |
|---|---|
| 1. m² Ref | 1. m² Ref |
| 3330 m² 2. m² Ref | 2. m² Ref |
| 3. m² Ref | 3. m² Ref |
| 4. m² Ref | 4. m² Ref |

Per ngritje e perbehkuri PALLAT

Koeficienti i Pjesemarrjes %

Nr. i Pasurise (Pallat)

Vol. Fq.

TRANSAKSIONI I PRONESISE

| Nr. | Data Regjistrim | Emri Atesia Mbiemri | Nr. Pasap | I/F/B | Adresa e Pronari | Shuma e Paguar | Data e Lesh. Certifikates | Shenime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 25-11-199 | SHTOTI | | | KAMEZ, TIRANE | | | | |

**VENDIM**
**Nr. 435, datë 3.6.2020**

**PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT, PARAUNIVERSITAR, TË ARSIMIT BAZË DHE TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË "*WOODROW WILSON INTERNATIONAL*", KU MËSIMI ZHVILLOHET EDHE NË GJUHËN ANGLEZE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e lejes shoqatës "*Woodrow Wilson*" për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë "*Woodrow Wilson International*", ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhën angleze dhe forma e arsimimit do të jetë arsim me kohë të plotë.

2. Institucioni arsimor privat, parauniversitar, i arsimit bazë dhe i arsimit të mesëm të lartë, "*Woodrow Wilson International*", duhet të vendosë në dispozicion të institucionit arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar në zbatim të akteve rregullatore në fuqi.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe institucioni arsimor privat, parauniversitar, i arsimit bazë dhe i arsimit të mesëm të lartë, "*Woodrow Wilson International*" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 436, datë 3.6.2020**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË OSE TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË VITET E NDËRMJETME TË KËTYRE PROGRAMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITET AKADEMIKE 2020–2021 DHE 2021-2022 E NË VIJIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 74, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u pranuar në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020–2021, përkatësisht, si më poshtë:

a) Në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, kandidatët, që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë, minimalisht me notë mesatare 6.5 (gjashtë pikë pesë);

b) Në programet e studimit të gjuhëve të huaja, të përcaktuara në shtojcën nr. 1 të këtij vendimi, minimalisht me notë mesatare 7 (shtatë);

c) Në programet e studimit të ciklit të parë *Bachelor*, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë, të përcaktuara në shtojcën nr. 2, të këtij vendimi, minimalisht me notë mesatare 7.5 (shtatë pikë pesë).

2. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u pranuar në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2021–2022 dhe në vijim, përkatësisht, si më poshtë:

a) Në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë, minimalisht me notë mesatare 7 (shtatë);

b) Në programet e studimit të ciklit të parë *Bachelor*, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë master, në fushën e mësuesisë, të përcaktuara në shtojcën nr. 2 të këtij vendimi, minimalisht me notë mesatare 8 (tetë).

3. Përjashtohen nga detyrimi i plotësimit të kriterit të notës mesatare kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare, me karakter profesional, kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve në fushën e artit dhe të sportit, si dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Republika e Kosovës, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci.

4. Në rastet e transferimit të studimeve nga brenda apo jashtë vendit, në vitet e ndërmjetme të programeve të studimit, brenda të njëjtit cikël, studentët duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave të vitit akademik, që studenti është pranuar në institucionin e arsimit të lartë, duke filluar nga viti akademik 2016–2017 dhe në vijim.

5. Nota mesatare për pranimin në institucionet e arsimit të lartë përllogaritet si mesatare e thjeshtë e treguesve, si më poshtë vijon:

a) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë;

b) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore.

6. Institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, janë përgjegjëse për përllogaritjen e notës mesatare dhe dërgimin e këtyre të dhënave në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.

7. Procedurat për njëvlershmërinë e dokumenteve të paraqitura nga shtetasit shqiptarë dhe të huaj, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit, si dhe përllogaritja e notës mesatare për këta kandidatë të kryhen në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, sipas përcaktimeve të pikës 5 të këtij vendimi. Në rastet kur nuk aplikohen provimet e Maturës Shtetërore, komisioni përkatës përcakton mënyrën e përllogaritjes së notës mesatare. Komisioni përkatës dërgon të dhënat tek institucioni arsimor vendor përkatës, përgjegjës për arsimin parauniversitar.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucionet e arsimit të mesëm të lartë, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

SHTOJCA 1
(PROGRAMET E STUDIMIT TË GJUHËVE TË HUAJA,
PËR VITIN AKADEMIK 2020–2021)

| Nr. | INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË | PROGRAMI I STUDIMIT | NOTA MESATARE |
|---|---|---|---|
| 1 | Universiteti i Tiranës | Gjuhë angleze | 7 |
| 2 | | Gjuhë angleze (Sarandë) | 7 |
| 3 | | Gjuhë frënge | 7 |
| 4 | | Gjuhë gjermane | 7 |
| 5 | | Gjuhë greke | 7 |
| 6 | | Gjuhë italiane | 7 |
| 7 | | Gjuhë ruse | 7 |
| 8 | | Gjuhë turke | 7 |
| 9 | | Gjuhë spanjolle me profil gjuhë - letërsi dhe qytetërim hispanik | 7 |

| Nr. | | PROGRAMI I STUDIMIT | NOTA MESATARE |
|---|---|---|---|
| 1 | Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" | Gjuhë angleze | 7 |
| 2 | | Gjuhë frënge | 7 |
| 3 | | Gjuhë gjermane | 7 |
| 4 | | Gjuhë italiane | 7 |
| **Nr.** | Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës | **PROGRAMI I STUDIMIT** | **NOTA MESATARE** |
| 1 | | Gjuhë gjermane dhe angleze | 7 |
| 2 | | Gjuhë angleze | 7 |
| **Nr.** | Universiteti "Fan S. Noli", Korçë | **PROGRAMI I STUDIMIT** | **NOTA MESATARE** |
| 1 | | Gjuhë angleze | 7 |
| | | Gjuhë dhe kulturë frënge | 7 |
| **Nr.** | Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë | **PROGRAMI I STUDIMIT** | **NOTA MESATARE** |
| 1 | | Gjuhë angleze | 7 |
| 2 | | Gjuhë italiane | 7 |
| **Nr.** | Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër | **PROGRAMI I STUDIMIT** | **NOTA MESATARE** |
| 1 | | Gjuhë angleze | 7 |
| 2 | | Gjuhë frënge | 7 |
| 3 | | Gjuhë gjermane | 7 |
| 4 | | Gjuhë italiane | 7 |
| **Nr.** | Kolegji universitar "Logos" | **PROGRAMI I STUDIMIT** | **NOTA MESATARE** |
| 1 | | Gjuhë dhe civilizim grek | 7 |
| **Nr.** | Kolegji universitar "Bedër" | **PROGRAMI I STUDIMIT** | **NOTA MESATARE** |
| 1 | | Gjuhë dhe letërsi angleze | 7 |
| **Nr.** | Universiteti privat "Albanian University" | **PROGRAMI I STUDIMIT** | **NOTA MESATARE** |
| 1 | | Anglisht | 7 |
| **Nr.** | Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër | **PROGRAMI I STUDIMIT** | **NOTA MESATARE** |
| 1 | | Histori dhe gjuhë italiane | 7 |

SHTOJCA NR. 2
(PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË *BACHELOR*, TË CILAT JAPIN AKSES NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË MASTER, NË FUSHËN E MËSUESISË, PËR VITIN AKADEMIK 2020–2021 DHE 2021–2022 E NË VIJIM)

| Nr. | INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË | PROGRAMI I STUDIMIT | NOTA MESATARE, VITI AKADEMIK 2020–2021 | NOTA MESATARE, VITI AKADEMIK 2021–2022 DHE NË VIJIM |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Universiteti i Tiranës | Biologji | 7.5 | 8 |
| 2 | | Filozofi | 7.5 | 8 |
| 3 | | Fizikë | 7.5 | 8 |
| 4 | | Gjeografi | 7.5 | 8 |
| 5 | | Gjuhë-letërsi | 7.5 | 8 |
| 6 | | Histori | 7.5 | 8 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 7 | | Informatikë | 7.5 | 8 |
| 8 | | Kimi | 7.5 | 8 |
| 9 | | Matematikë | 7.5 | 8 |
| 10 | | Psikologji | 7.5 | 8 |
| 11 | | Sociologji | 7.5 | 8 |
| **Nr.** | | **PROGRAMI I STUDIMIT** | **NOTA MESATARE** | **NOTA MESATARE** |
| 1 | Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" | Biologji-kimi | 7.5 | 8 |
| 2 | | Edukim qytetar | 7.5 | 8 |
| 3 | | Filozofi-sociologji | 7.5 | 8 |
| 4 | | Gjeografi dhe gjuhë italiane | 7.5 | 8 |
| 5 | | Gjuhë shqipe dhe letërsi | 7.5 | 8 |
| 6 | | Histori-gjeografi | 7.5 | 8 |
| 7 | | Histori dhe gjuhë gjermane | 7.5 | 8 |
| 8 | | Matematikë informatike | 7.5 | 8 |
| 9 | | Matematikë-fizikë | 7.5 | 8 |
| 10 | | Mësuesi për arsim parashkollor | 7.5 | 8 |
| 11 | | Mësuesi për arsim fillor | 7.5 | 8 |
| 12 | | Psikologji | 7.5 | 8 |
| 13 | | Gjuhë shqipe dhe frënge | 7.5 | 8 |
| 14 | | Gjuhë shqipe dhe rome | 7.5 | 8 |
| **Nr.** | | **PROGRAMI I STUDIMIT** | **NOTA MESATARE** | **NOTA MESATARE** |
| 1 | Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës | Gjuhë-letërsi-anglisht | 7.5 | 8 |
| 2 | | Histori | 7.5 | 8 |
| 3 | | Informatikë-anglisht | 7.5 | 8 |
| 4 | | Matematikë-informatikë | 7.5 | 8 |
| 5 | | Mësuesi për arsim fillor | 7.5 | 8 |
| 6 | | Mësuesi për arsim parashkollor | 7.5 | 8 |
| 7 | | Psikologji | 7.5 | 8 |
| 8 | | Filozofi-sociologji | 7.5 | 8 |
| **Nr.** | | **PROGRAMI I STUDIMIT** | **NOTA MESATARE** | **NOTA MESATARE** |
| 1 | Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër | Biologji - kimi | 7.5 | 8 |
| 2 | | Gjuhë-letërsi shqipe | 7.5 | 8 |
| 3 | | Gjuhë-letërsi angleze | 7.5 | 8 |
| 4 | | Gjuhë-letërsi dhe qytetërim grek | 7.5 | 8 |
| 5 | | Gjuhë-letërsi italiane | 7.5 | 8 |
| 6 | | Histori-gjeografi | 7.5 | 8 |
| 7 | | Matematikë-informatikë | 7.5 | 8 |
| 8 | | Mësuesi për arsimin fillor | 7.5 | 8 |
| 9 | | Mësuesi për arsimin | 7.5 | 8 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | parashkollor | | |
| 10 | | Fizikë dhe teknologji informacioni | 7.5 | 8 |
| 11 | | Matematikë-fizikë | 7.5 | 8 |
| **Nr.** | | **PROGRAMI I STUDIMIT** | **NOTA MESATARE** | **NOTA MESATARE** |
| 1 | Universiteti "Fan S. Noli", Korçë | Biologji-kimi | 7.5 | 8 |
| 2 | | Filozofi-sociologji | 7.5 | 8 |
| 3 | | Gjuhë-letërsi | 7.5 | 8 |
| 4 | | Histori-gjeografi | 7.5 | 8 |
| 5 | | Matematikë - fizikë | 7.5 | 8 |
| 6 | | Matematikë - informatikë | 7.5 | 8 |
| 7 | | Mësuesi për arsimin fillor | 7.5 | 8 |
| 8 | | Mësuesi për arsimin parashkollor | 7.5 | 8 |
| **Nr.** | | **PROGRAMI I STUDIMIT** | **NOTA MESATARE** | **NOTA MESATARE** |
| 1 | Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë | Biologji | 7.5 | 8 |
| 2 | | Fizikë | 7.5 | 8 |
| 3 | | Gjuhë shqipe dhe letërsi | 7.5 | 8 |
| 4 | | Histori-gjeografi | 7.5 | 8 |
| 5 | | Informatikë | 7.5 | 8 |
| 6 | | Kimi | 7.5 | 8 |
| 7 | | Matematikë | 7.5 | 8 |
| 8 | | Mësuesi për arsimin fillor | 7.5 | 8 |
| 9 | | Mësuesi për arsimin parashkollor | 7.5 | 8 |
| 10 | | Pedagogji e specializuar | 7.5 | 8 |
| **Nr.** | | **PROGRAMI I STUDIMIT** | **NOTA MESATARE** | **NOTA MESATARE** |
| 1 | Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër | Biologji - kimi | 7.5 | 8 |
| 2 | | Fizikë | 7.5 | 8 |
| 3 | | Gjeografi | 7.5 | 8 |
| 4 | | Gjuhë-letërsi | 7.5 | 8 |
| 5 | | Histori | 7.5 | 8 |
| 6 | | Informatikë | 7.5 | 8 |
| 7 | | Matematikë | 7.5 | 8 |
| 8 | | Mësuesi për arsim fillor | 7.5 | 8 |
| 9 | | Mësuesi për arsim parashkollor | 7.5 | 8 |
| 10 | | Psikologji | 7.5 | 8 |
| **Nr.** | | **PROGRAMI I STUDIMIT** | **NOTA MESATARE** | **NOTA MESATARE** |
| 1 | Kolegji universitar "Bedër" | Arsimi parashkollor dhe fillor | 7.5 | 8 |
| 2 | | Psikologji këshillimi dhe Pedagogji | 7.5 | 8 |

| Nr. | Kolegji universitar "Wisdom" | PROGRAMI I STUDIMIT | NOTA MESATARE | NOTA MESATARE |
|---|---|---|---|---|
| 1 | | Psikologji | 7.5 | 8 |
| **Nr.** | SHLUJ, Universiteti "Marin Barleti" | **PROGRAMI I STUDIMIT** | **NOTA MESATARE** | **NOTA MESATARE** |
| 1 | | Psikologji | 7.5 | 8 |
| **Nr.** | Universiteti Europian i Tiranës | **PROGRAMI I STUDIMIT** | **NOTA MESATARE** | **NOTA MESATARE** |
| 1 | | Psikologji | 7.5 | 8 |
| 2 | | Sociologji | 7.5 | 8 |
| 3 | | Filozofi | 7.5 | 8 |
| 4 | | Histori | 7.5 | 8 |
| 5 | | Letërsi | 7.5 | 8 |
| 6 | | Linguistikë | 7.5 | 8 |
| 7 | | Arsim parashkollor | 7.5 | 8 |
| **Nr.** | Universiteti i *New York*-ut në Tiranë | **PROGRAMI I STUDIMIT** | **NOTA MESATARE** | **NOTA MESATARE** |
| 1 | | Psikologji | 7.5 | 8 |
| **Nr.** | Universiteti privat "Albanian University" | **PROGRAMI I STUDIMIT** | **NOTA MESATARE** | **NOTA MESATARE** |
| 1 | | Mësuesi për arsimin fillor | 7.5 | 8 |
| 2 | | Mësuesi për arsimin parashkollor | 7.5 | 8 |
| 3 | | Psikologji e përgjithshme | 7.5 | 8 |
| **Nr.** | Kolegji universitar "Logos" | **PROGRAMI I STUDIMIT** | **NOTA MESATARE** | **NOTA MESATARE** |
| 1 | | Mësuesi për arsimin parashkollor | 7.5 | 8 |

**VENDIM**
**Nr. 437, datë 3.6.2020**

## PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2020, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në buxhetin e vitit 2020, në programin buxhetor "Arsimi bazë" 09120, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", i shtohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh, për pagesën e TVSH-së së dhurimit të pajisjeve tablet nga fondacioni "Vodafone *Albania*".

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2020.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 438, datë 3.6.2020**

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURSIT "TOKË BUJQËSORE" NË "TOKË URBANE", TRUALL, TË NJË SIPËRFAQEJE TË PASURISË ME NUMËR 35, ZONA KADASTRALE 1903, BASHKIA POGRADEC**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, për sipërfaqen prej 498.3 (katërqind e nëntëdhjetë e tetë pikë tre) $m^2$, pjesë të pasurisë me numër 35, zona kadastrale 1903, fshati Gurras, Njësia Administrative Buçimas, Bashkia Pogradec, sipas certifikatës së pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Korçë, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga kategoria "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të sipërfaqes prej 498.3 (katërqind e nëntëdhjetë e tetë pikë tre) $m^2$, pjesë e pasurisë me numër 35, zona kadastrale 1903, Bashkia Pogradec.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Korçë dhe Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË

PËR VËRTETIM PRONËSIE

1458517

Zyra e Regjistrimit: Z.V.R.P.P. POGRADEC — Zona Kadastrale Nr.: 1903

Numri i Pasurisë: 35 — Volumi: 10 — Faqe: 13

Adresa e Pasurisë: GURRAS

Lloji i Pasurisë: PEMETORE

Sipërfaqja Totale: 9400.00 m2

Nga kjo : Sa Truall: — Nga kjo : Sa Ndërtesa: -

Nga pallat : Kuota e pjesëmarrjes: - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti ( Zotërinjtë )

| Emri | Atësia | Mbiemri | Pjesa | Adresa |
|---|---|---|---|---|
| REPUBLIKA | E | SHQIPERISE | 1/1 | |

- është pronar i pasurisë me numër 35
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V ____, L ____, J ____, P ____

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 3/2/2017 Nr. 607

Data e lëshimit të çertifikatës: 3/2/2017

Lëshuesi i certifikatës
REGJISTRUESI
LEONAT MUSKOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPERISE ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME Z.V.R.P.P. POGRADEC


HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT
POGRADEC
REGJISTRUESI
LEONAT MUSKOLLARI
HARTOGRAF
A. IDENTIFIKIMI I PASURISE
ZONA KADASTRALE 1903 NR I PASURISE 35 Vol 10 Fq 13
INDEKSI I HARTES K - 34 - 114 - (88-A). SHKALLA 1:2500
ADRESA E PASURISE Rruga Pogradec QU Gurras
B. KUFIZIMET
V. 34; 36
L. 285
J. 288
P. 282
C. PRONARI/ET
REPUBLIKA E SHQIPERISE
D. Data: 03/02/2017, Ora:
Veri
2/1
1
28
283
284
30
29
32
31
33
34
36
35
285
250
209
/8

**Lidhja nr. 1**

| Nr. rend | Qarku | Bashkia | Zona kadastrale | Adresa e pasurisë | Numri i pasurisë | Sipërfaqja në m² | Sipërfaqja që përdoret për zhvillim m² | Sipërfaqja ndërtimore m² | Emërtimi i strukturës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Korçë | Pogradec | 1903 | Gurrës | 35 | 9400 | 2900 | 498.3 | Inkubator agroushqimor |

**VENDIM**
**Nr. 439, datë 3.6.2020**

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURSIT "TOKË BUJQËSORE" NË "TOKË URBANE", TRUALL, TË NJË SIPËRFAQEJE TË PASURISË ME NUMËR 85/2, ZONA KADASTRALE 1553, BASHKIA MALIQ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, për sipërfaqen prej 1 326 (një mijë e treqind e njëzet e gjashtë) $m^2$, pjesë e pasurisë me numër 85/2, zona kadastrale 1553, Bashkia Maliq, sipas certifikatës së pronësisë së pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Korçë, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, për sipërfaqen ndërtimore prej 1 326 (një mijë e treqind e njëzet e gjashtë) $m^2$, sipas lidhjes nr. 1, të pasurisë me numër 85/2, zona kadastrale 1553, Bashkia Maliq.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Korçë dhe Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

Miratuar nga V. K. M. Nr. 515, Date 7.11.1994

## KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol. 3 Fq. 127

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Zona Kadastrale 1555 NR. i PASURISE: 85/2

Indeksi i Hartes: K-34-114-216-D

Vijon ne: Vol. Fq. dera ne: Vol. Fq.

Adresa e Pasurisë: Rrethi KORCË QF. DRITHAS

PERFUNDIMTARE (data):

Nr.L. P/G SH K Ap

Pershkrimi i veçimit

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: ARE Brenda V.K.N.: JO , Ref:

| Sip. Totale e Pasurisë | Nga Sip. Totale: sa Truall | Nga Sip. Truall: sa Ndertese |
|---|---|---|
| 1 20.000,00 m² Ref: AKTI 1712 | 1. m² Ref: | 1. m² Ref: |
| 2 20.000,00 m² Ref: LN 1995 | 2. m² Ref: | 2. m² Ref: |
| 3 m² Ref: | 3. m² Ref: | 3. m² Ref: |
| 4 m² Ref: | 4. m² Ref: | 4. m² Ref: |

Per pjesen e përbashkët:
PALLAT
Kuota e pjesmarrjes: %
Nr i Pasurise (pallat):
Vol. Faqe

C - SEKSIONI I PRONESISE

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Emri Atësia Mbiemri | Nr. Pasap | I/F/B | Adresa e Pronarit | Shuma e Paguar | Data e Lësh Certifikates | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 00001414 | 06/11/2018 | Ilirjan Ferit Pergu<br>Sellver Hysnet Pergu | F80126132X | B | -<br>- | 4,500,000 | 13/11/2018 | KPI | |

Shenim: Kolona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfaqesues i familjes; B - bashkëpronar (*s)

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh. Certifikates | Shenime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh. Certifikates | Shenime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME KORÇË
Adresa: Rruga 11 Nentori,Lagj. Brigada 17 S (prane Prefektures)

KORÇË, me 16 / 1 / 2019

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tonë
Në regjistrin Vol 3 , Faqe 127 , Zona Kadastrale 1553 , Qyteti Korce

REGJISTRUESI

Veselina Gusho

Digitally signed by Veselina Gusho
DN: c=AL, l=Pogra dec, o=Privat, title=Arkitekt, cn=Veselina Gusho
Date: 2019.01.24 20:32:05 +01'00'


Veselina Gusho
Digitally signed by Veselina Gusho
DN: c=AL, l=Pogradec, o=Privat, title=Arkitekt, cn=Veselina Gusho
Date: 2019.01.24 20:31:38 +01'00'
HARTA TREGUESE REGJISTRIMIT
(Fragment)
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT KORÇË
REGJISTRUES
Nada BANDILLI
Z.V.R.P.P KORÇË
A. IDENTIFIKIMI I PASURISE
Z.KADASTRALE 1553 NR PASURIE 85/2 Vol 3 Fq 127
INDEKSI HARTES K-34-114-216-0 SHKALLA 1:250
ADRESA E PASURISE: Rrethi KORÇË Qif DRITHAS
Rrl L P/G Sh K Ap
B. KUFIZIMET
V. 268
L 85/3
J. 285
P. 85/1
C. PRONARET
IURJAN FERIT PENOL
D.Data: 16/01/2019
Ora
268
269
270
84/4
84/2
85/3
85/4
84/6
85/7
85/8
84/1
84/3

Veselina Gusho

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1817794
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. KORCË Zona Kadastrale Nr. 1553
Numri i Pasurisë 85/2 Volumi 3 Faqe 127
Adresa e Pasurisë DRITHAS
Lloji i Pasurisë ARE
Sipërfaqja Totale 20000.00 m2
Nga kjo : Sa Truall Nga kjo : Sa Ndërtesa -
Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti ( Zotërinjtë )

| Emri Atësia Mbiemri | Pjesa | Adresa |
|---|---|---|
| ILIRJAN FERIT PENGU | 1/2 | |
| SATBER HYSMET PENGU | 1/2 | |

- është pronar i
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart tek pasuria me numër 85/2
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V 268 , L 8513 , J 285 , P 85/1

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 6/11/2018 Nr. 15714

Data e lëshimit të certifikatës
13/11/2018

Lëshuesi i certifikatës
REGJISTRUESI
NADA BANDILLI

Veselina Gusho

**Lidhja nr. 1**

| Nr. rendi | Qarku | Bashkia | Zona kadastrale | Adresa e pasurisë | Numri i pasurisë | Sipërfaqja e pasurisë m² | Sipërfaqja ndërtimore m² | Emërtimi i strukturës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Korçë | Maliq | 1553 | Drithas | 85/2 | 20000 | 1326 | Objekt për grumbullimin e produkteve bujqësore |

**VENDIM**
**Nr. 440, datë 3.6.2020**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 410, DATË 27.6.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE TË NDRYSHIMIT TË KATEGORIVE TË RESURSEVE TË TOKËS"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 410, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në përmbajtje të vendimit:

a) emërtimi: "Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit" zëvendësohet me fjalët: "... ministria përgjegjëse për bujqësinë …";

b) emërtimi: "Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave" zëvendësohet me fjalët: "... ministria përgjegjëse për mjedisin ...";

c) fjala: "... komunë ..." hiqet;

ç) fjalët: "... specialisti i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë ..." zëvendësohen me "... specialisti i Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor ...".

2. Kreu IV ndryshohet, si më poshtë vijon:

"IV. NDRYSHIM I TOKËS SË PAFRYTSHME DHE TOKË URBANE, TRUALL, NË KATEGORINË E RESURSIT TOKË BUJQËSORE

1. Subjekti i interesuar për ndryshim të kategorisë së resursit, nga tokë e pafrytshme ose tokë urbane, truall, në kategorinë e resursit "tokë bujqësore", paraqet kërkesë në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë. Kërkesa përmban:

a) dokumentin e pronësisë, kartelën e pasurisë së paluajtshme, shoqëruar me hartën kadastrale ose planin e rilevimit, të përgatitur sipas standardit të miratuar nga një ekspert topograf i licencuar, ku të përcaktohen qartë kufijtë e pronës. Kur subjekti është institucion shtetëror dhe e ka tokën në administrim, paraqet aktin mbi të cilin e ka marrë në përgjegjësi administrimi ose në përdorim;

b) vërtetimin për gjendjen e resursit, lëshuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, e qarkut.

2. Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë merr mostra në terren për profilin dhe numrin e tyre për çdo parcelë, sipas rregullave të miratuara nga ministri me udhëzim. Pagesa për kryerjen e analizave dhe shpenzimet për marrjen e mostrave, sipas tarifave të miratuara, kryhet nga subjekti i interesuar.

3. Qendra e Transferimit të Tokës Bujqësore Fushë-Krujë përgatit rezultatin e analizave dhe raportin teknik dhe, në përputhje me konkluzionet, propozon kalimin e sipërfaqes së tokës në tokë bujqësore ose refuzimin e kërkesës. Raporti i analizave, raporti teknik dhe dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, përcillet në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, shoqëruar me propozimin për pranimin ose refuzimin e kërkesës.

4. Dokumentacioni shqyrtohet nga struktura/ sektori i administrimit të tokave në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, i cili përgatit raport përmbledhës për ministrin, bashkë me projekturdhrin përkatës.

5. Ministri përgjegjës për bujqësinë, në bazë të procedurës së kryer nga Qendra e Transferimit të Tokës Bujqësore Fushë-Krujë dhe raportit të strukturës/sektorit të administrimit të tokave në ministri, miraton me urdhër ndryshimin në resursin tokë bujqësore.

6. Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, ku ndodhet toka, bën ndryshimin në bazë të përcaktimeve të urdhrit të ministrit.

7. Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës bën ndryshimin e llojit të pasurisë sipas procedurës më sipër, me kërkesën e subjektit të interesuar dhe pas kryerjes së pagesës së tarifave nga ky i fundit ose personi i autorizuar prej tij.".

3. Pika 1, e kreut VI, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Subjektet e interesuara për ndryshim të kategorisë së resursit të tokës bujqësore, nga V deri në X të bonitetit, për kalimin e tyre në tokë urbane, truall, në tokë për veprimtari minerare e gjeologjike, për gurore dhe karriera, në bashkitë ku nuk janë miratuar planet e përgjithshme vendore, paraqesin kërkesë në ministrinë përkatëse që mbulon këtë veprimtari. Kërkesa paraqitet sipas dispozitave të legjislacionit për planifikimin e territorit dhe përmban edhe vërtetimin për kategorinë e tokës sipas bonitetit, për sipërfaqen objekt kërkese, të lëshuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, e qarkut.".

4. Pika 1, e kreut VII, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Subjektet e interesuara për të ushtruar veprimtari në tokat bujqësore të kategorive nga I deri në IV të bonitetit, vetëm për rastet e domosdoshme, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, në bashkitë ku nuk janë miratuar planet e përgjithshme vendore, paraqesin kërkesë në ministrinë që mbulon veprimtarinë përkatëse, sipas dispozitave që rregullojnë veprimtaritë për planifikimin e territorit. Kërkesa duhet të përmbajë edhe vërtetimin për kategorinë e tokës sipas bonitetit, të lëshuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, e qarkut.".

5. Pas kreut VII, shtohet kreu VII/1, me këtë përmbajtje:

"VII/1. KALIMI I TOKAVE TË RESURSEVE TË NDRYSHME NË KATEGORINË E RESURSIT TOKË URBANE, TRUALL, SIPAS PLANEVE TË DETAJUARA DHE PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE

Në rastet kur planet e detajuara për zona të rëndësisë kombëtare, planet e përgjithshme vendore dhe planet e detajuara vendore janë miratuar dhe botuar në regjistrin e planifikimit të territorit, subjektet e interesuara për ndryshimin e kategorive të resurseve paraqesin për regjistrim në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, të qarkut, lejen e zhvillimit ose lejen e ndërtimit. Në këto raste, resursi i tokës ndryshohet sipas lejes së zhvillimit ose lejes së ndërtimit, konform planit të përgjithshëm vendor dhe planit të detajuar vendor. Leja e zhvillimit paraqitet për çdo parcelë.".

6. Pika 1, e kreut VIII, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Për kalimet dhe ndryshimet e kategorive të resurseve, të miratuara sipas rastit me akte ligjore apo nënligjore, me planet e detajuara për zona të rëndësisë kombëtare, planet e përgjithshme vendore dhe planet e detajuara vendore dhe mbështetur në to, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, e qarkut, ZMMT-ja në bashki, si dhe Drejtoria Rajonale Pyjore bëjnë përditësimin në dokumentacionin kadastral përkatës.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 441, datë 3.6.2020**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E HARTIMIT TË PROJEKTEVE PËR MIRATIMIN E LEJEVE TË NDËRTIMIT, PËR NDËRTIMIN E NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË ZONAT E SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR, NË BASHKITË DURRËS, KAVAJË, KRUJË, KURBIN, LEZHË, SHIJAK DHE VORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e hartimit të projektit për miratimin e lejeve të ndërtimit, përfshirë kostot për shërbime të rilevimeve topografike, vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe të shërbimeve gjeologjike që i takojnë nëntokës e punimeve në themel, për ndërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar, në bashkitë Durrës, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Shijak dhe Vorë, gjithsej në masën 202 644 869 (dyqind e dy milionë e gjashtëqind e dyzet e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

2. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit 06210 "Programe zhvillimi", i kalohet fondi në masën 202 644 869 (dyqind e dy milionë e gjashtëqind e dyzet e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, për financimin e hartimit të projekteve sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi.

3. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin "Fondi për rindërtim", të buxhetit të shtetit.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 442, datë 3.6.2020**

**PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE DURRËS, BASHKIA DURRËS, DHE CAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "iii" dhe "iv", dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, të zonës 5, Njësia Administrative Durrës, Bashkia Durrës, zonë e re për zhvillim.

2. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit për këtë zonë, si njësi zbatuese, për:

a) ndërtimin e banesave të reja ose të ndërtesave publike të dëmtuara;

b) ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike e kritike;

c) realizimin e ndërtimeve në këtë zonë;

ç) çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të kësaj zone.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Durrës dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**



**VENDIM**
**Nr. 445, datë 3.6.2020**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 780, DATË 6.11.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR CAKTIMIN E OFICERËVE KOORDINUES, PËR ÇËSHTJET E DIASPORËS SHQIPTARE, NË KONSULLATAT SHQIPTARE NË ITALI DHE GREQI"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31, të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 4, të vendimit nr. 780, datë 6.11.2019, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

"4/1. Përjashtimisht, për vitin 2020, efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, do të përballohen nga buxheti i miratuar për Agjencinë Kombëtare të Diasporës.".

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**URDHËR I PËRBASHKËT**
**Nr. 353, datë 29.5.2020**

**PËR MIRATIMIN E "PROTOKOLLIT TË MASAVE ANTI-COVID-19 PËRGJATË SEZONIT TURISTIK"**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7 dhe 9, të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni COVID-19,

URDHËROJ:

1. Miratimin e "Protokollit të masave anti-COVID-19 përgjatë sezonit turistik", sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
**Ogerta Manastirliu**

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
**Blendi Klosi**

**PROTOKOLLI I MASAVE ANTI-COVID-19**
PËRGJATË SEZONIT TURISTIK 2020
*(I vlefshëm përgjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19)*

**Parathënie**

"Protokolli i masave anti-COVID-19" është një dokument që rekomandohet të zbatohet nga sipërmarrjet turistike, turistët/pushuesit dhe vizitorët, për mbarëvajtjen e atyre aktiviteteve të miratuara si të lejuara, përmes akteve normative të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe institucioneve të tjera kompetente.

Ky Protokoll përmban parakushtet, kushtet dhe rregullat për të orientuar dhe për të rekomanduar industrinë turistike për masat e nevojshme që duhet të ndërmerren përgjatë periudhës së pranisë së infeksionit COVID-19.

Ky protokoll është një dokument publik, që u vihet në dispozicion të gjitha sipërmarrjeve turistike, por pa u kufizuar vetëm në to, për të garantuar mbarëvajtjen e suksesshme të aktivitetit turistik të lejuar, si dhe për parandaluar rrezikun e përhapjes së infeksionit COVID-19 gjatë zhvillimit të veprimtarisë turistike, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe të vizitorëve.

Protokolli duhet të zbatohet në bashkëshoqërim dhe në zbatim të protokolleve të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë dhe e

Mbrojtjes Sociale dhe është i hapur për ndryshim, në përputhje me dinamikën e situatës së infeksionit COVID-19."

**1. Informacione të përgjithshme**

**1.1 Qëllimi**

"Protokolli i masave anti-COVID-19 përgjatë sezonit turistik 2020" është një dokument mbështetës për të orientuar dhe për të rregulluar parakushtet, kushtet dhe kriteret e nevojshme që duhet të ndërmerren nga sipërmarrjet e shërbimeve turistike përgjatë sezonit turistik 2020, për të garantuar mbarëvajtjen e suksesshme të aktivitetit, si dhe për të parandaluar rrezikun e përhapjes së infeksionit COVID-19, brenda dhe jashtë sipërmarrjeve turistike, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe vizitorëve.

Masat e propozuara në këtë protokoll vihen në dispozicion të sipërmarrjeve e aktiviteteve turistike, në përputhje të plotë me masat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe nga institucione të tjera vendimmarrëse të qeverisë shqiptare.

**Ky protokoll është i vlefshëm vetëm në rast të heqjes së masave kufizuese nga qeveria shqiptare dhe në rast të lejimit të ushtrimit të aktiviteteve turistike, sipas zonave dhe territoreve të konfirmuara.**

**1.2 Fusha e aplikimit**

Për qëllimet e këtij protokolli, "sipërmarrje të aktiviteteve turistike" do të konsiderohet, por pa u kufizuar, çdo sipërmarrje që ofron shërbimin e akomodimit, ushqimit/pijeve, plazheve, aktiviteteve rekreative, transportit të turistëve vendës dhe/ose të huaj, udhërrëfyesve turistikë etj., përfshirë gjithë stafin e tyre me kohë të plotë dhe/ose të pjesshme.

**1.3 Përditësimi periodik**

Ky protokoll miratohet në datën 29.5.2020 dhe mund t'u nënshtrohet përditësimeve të ndryshme në bazë të situatës së krijuar, si pasojë e infeksionit COVID-19, si dhe kushteve apo masave të tjera në funksion të ruajtjes së shëndetit të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë dhe vizitorëve të huaj.

**1.4 Kredite**

Ky dokument është përgatitur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke u konsultuar gjerësisht me të gjitha grupet e interesit vendës dhe të huaj, si dhe bazuar në praktikat më të mira evropiane dhe botërore.

**2. Informimi rreth masave anti-COVID-19**

**2.1 Informimi i masave anti-COVID-19 nga sipërmarrjet e aktiviteteve turistike**

Çdo sipërmarrje turistike që lejohet të ushtrojë aktivitetin rekomandohet të adaptojë këtë protokoll dhe të afishojë masat respektive në vende qartësisht të dukshme dhe pranë korridoreve të kalimit të njerëzve, mbështetur me materiale të ndryshme promovuese dhe informuese që informojnë mbi masat që duhen ndërmarrë për parandalimin e infeksionit COVID-19.

Aty ku është e mundur të përdoren materiale promovuese të mirëkoordinuara në nivel kombëtar, duke u mbështetur në mënyrë rigoroze dhe të njësuara me udhëzimet e nxjerra për këtë qëllim nga institucionet qendrore të qeverisë shqiptare.

Materialet promovuese, afishet dhe broshurat rekomandohet të publikohen në dy gjuhë, shqip dhe anglisht ose edhe në gjuhën e vizitorëve të sipërmarrjes turistike.

Stafi menaxhues i sipërmarrjeve të aktiviteteve turistike duhet t'ia promovojë dhe t'ia rikujtojë këto masa stafeve të brendshme mbështetëse, si dhe vizitorëve, mbi baza periodike, në formë dhe mënyrë të qartë, madje edhe kur konsiderohet se janë bërë trajnime dhe janë marrë masat e nevojshme për parandalimin e infeksionit COVID-19.

**3. Garantimi i shëndetit të stafit dhe i vizitorëve, si dhe menaxhimi i rastit të dyshuar me COVID-19**

**3.1 Mbajtja e dorezave dhe e maskave**

Rekomandohet që administratori i sipërmarrjes turistike ose një person i përcaktuar prej tij, të monitorojë procesin dhe stafin, lidhur me respektimin e masave të higjienës dhe të distancës fizike, që duhen ndërmarrë për parandalimin e infeksionit COVID-19.

Stafi i shërbimit, që ka kontaktet me pushuesit/vizitorët duhet të përdorë doreza dhe maska mbrojtëse. Mbajtja e dorezave dhe e maskave janë elemente të domosdoshme në parandalimin e transmetimit të COVID-19, e kombinuar me higjienën të duarve.

**3.2 Trajtimi i rasteve simptomatike**

Në rast se një person i pranishëm, brenda strukturës akomoduese/sipërmarrjes turistike (vizitor, staf etj.) ka ethe dhe simptoma të një infeksioni respirator (kollë e thatë, dhimbje të fytit, vështirësi në frymëmarrje), ai duhet të njoftojë menjëherë administratorin/ose personin e caktuar prej tij, i cili njofton menjëherë Urgjencën Kombëtare, 127-ën, dhe NJVKSH-në e njësisë vendore që i përket sipërmarrja turistike. Komunikimi duhet të bëhet mundësisht vetëm përmes telefonit.

**3.3 Masat higjieno-sanitare gjatë procesit të regjistrimit dhe të shoqërimit të vizitorëve**

- Punonjësit e recepsionit duhet të jenë të mirinformuar në lidhje me masat anti-COVID-19, në mënyrë që ata të mund të kryejnë detyrat e tyre të caktuara dhe të parandalojnë përhapjen e mundshme të infeksionit në strukturën akomoduese.

- Recepsioni duhet të ketë në dispozicion numrat e telefonit të autoriteteve shëndetësore, (Urgjencën Kombëtare dhe Epidemiolgjinë e NJVKSH-së përkatëse), si dhe të afishojë masat anti-COVID-19 në vend të dukshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm për të gjithë.

- Stafi i recepsionit duhet të mbajë pastër ambientin e tyre të punës dhe në fund të çdo ndërrimi turni të pastrojë me kujdes tryezën dhe pajisjet (për shembull: telefon, tastierë, ekran me prekje, stilolapsa, lapsa etj.). Për të lehtësuar performancën dhe efektivitetin e këtij operacioni, është e përshtatshme të hiqen të gjitha sendet jothelbësore nga sipërfaqja e punës.

- Nëse mjetet e punës përdoren nga shumë njerëz gjatë të njëjtit turn, rekomandohet që stafi të lajë duart më shpesh dhe t'i dezinfektojë me xhel, me përbërje alkooli 70–85%. Shkëmbimi i telefonave dhe i celularit duhet të shmanget, nëse nuk dezinfektohet siç duhet para se të kalojë nga një operator tek tjetri[1].

- Rekomandohet që nga sipërmarrja turistike të merren masa për të shmangur mbledhjet e shumë njerëzve në të njëjtin vend, si dhe për të zvogëluar në maksimum kohën e pritjes përgjatë procesit të regjistrimit. Kur është e mundur, të përdoret sistem elektronik për regjistrimin. Në strukturat akomoduese duhet të ruhet distancimi fizik i rekomanduar nga MSHMS-ja.

**3.4 Masa të përgjithshme të pastrimit dhe të lëvizjes**

Rekomandohet pastrim i përsëritur i ambienteve.

Pavarësisht përdorimit të maskave dhe të dorezave me një përdorim, higjienizimi dhe larja e shpeshtë e duarve konsiderohet e domosdoshme. Pasi t'i keni larë duart me sapun dhe ujë, ju duhet t'i thani ato plotësisht. Xheli me përbërje alkoolike për higjienën e duarve duhet të përdoret në mënyrë periodike, madje edhe kur mbahen doreza.

- Maska, doreza të disponueshme dhe dezinfektues sipërfaqësor, mund të jenë në dispozicion për vizitorët kundrejt një marrëveshje paraprake mes sipërmarrjes dhe pushuesve/vizitorëve.

- Struktura akomoduese duhet të vendosë në holle, korridore dhe ambiente të jashtme kosha të pajisur me qese plastike, për të hedhur mbetjet e mjeteve mbrojtëse higjienike.

- Rekomandohet të fillohet me ajrosjen natyrale të dhomës, duke hapur dritaret nëse ka.

- Pastrimi duhet të përfshijë të gjitha sipërfaqet, siç janë: tavolinat, krevatet, karriget, telefoni, telekomanda, dorezat e dyerve dhe panelet, si dhe çdo pajisje tjetër që konsiderohet se mund të jetë e prekur nga vizitori.

- Sipërfaqet që mund të ndoten me sekrecione të frymëmarrjes ose lëngje të tjera të trupit të personit, p.sh.: tualeti, basenet e larjes së duarve dhe banjat, duhet të pastrohen me solucion të rregullt dezinfektues që përmban 0.1% hipoklorit të natriumit dhe të lihen pa u shpëlarë me ujë për 10 minuta. Sipërfaqet duhen shpëlarë me ujë të pastër pas 10 minutash kontakti me klorin.

- Kur përdorimi i klorit nuk është i përshtatshëm, p.sh.: pajisje telefonike, telekomandë, doreza derë, butona në ashensor etj., atëherë mund të përdoret alkooli 70%.

- Kur është e mundur, të përdoren vetëm materiale pastrimi me një përdorim.

- Të gjithë artikujt e përdorur me një përdorim (peshqir dore, doreza, maska) duhet të vendosen në një enë me kapak dhe të hidhen sipas menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme.

[1] http://www.euro.who.int/en/health-topics/health-emergencies/coronavirus-covid-19/publications/2020/operational-considerations-for-covid-19-management-in-the-accommodation-sector-interim-guidance,-31-march-2020

- Nëse minibari është i pranishëm dhe aktiv, në secilin ndryshim të vizitorit rekomandohet të pastrohen të gjitha sipërfaqet e minibarit në mënyrë sistematike.

- Dyshemetë pastrohen dhe sanitarizohen me produkte të përshtatshme.

- Këshillohet të shmangni pajisjen e dhomave ose të dhomave të tjera të strukturës me elementë arredimi, që nuk janë objekte të pastrimit të përditshëm.

**3.5 Higjiena e përgjithshme**

- Dhomat duhet të mirëmbahen me standarde të larta pastërtie.

- Të gjitha sipërfaqet duhet të pastrohen të paktën çdo ditë me pastrues dhe ujë ose dezinfektues.

- Zonat me prekje të shpeshtë, siç janë: parmakët, panelet e kontrollit të ashensorit ose dorezat e dyerve, rekomandohet të pastrohen shpesh.

- Duart duhet të lahen pas çdo veprimtarie pastrimi.

- Tualetet rekomandohen të lahen me ujë dhe dezinfektant. Ato duhet të jenë të pajisura me sapun të lëngshëm, peshqirë letre ose tharëse duarsh.

- Dezinfektoni mjedisin me dezinfektues të holluar sipas rekomandimeve dhe standardeve të përcaktuara nga MSHMS-ja. Lëreni për 15–30 minuta para se ta shpëlani me ujë dhe ta pastroni.

Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet zbatimit të masave të pastrimit dhe të dezinfektimit në të gjitha zonat (bufe, bare, restorante, kuzhina etj.), si një masë parandaluese e përgjithshme gjatë gjithë epidemisë COVID-19. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet objekteve që preken shpesh, siç janë tavolinat, karriget, enët prej porcelani, mbajtëset e kripës, piperit, pecetave etj. të këtij lloji. Këto objekte duhet të pastrohen dhe të dezinfektohen përpara nisjes së orarit të vaktit të ngrënies dhe/ose sa herë që duket e nevojshme.

**3.6 Ventilimi**

I referohet procesit të furnizimit dhe të largimit të ajrit në ambient, i cili mund të arrihet me mjete natyrore dhe mekanike. Filtrat rekomandohet të pastrohen rregullisht dhe të zëvendësohen sipas manualeve teknike dhe udhëzimeve të prodhuesit. Dezinfektoni të gjitha sipërfaqet që konstatohen se kanë rritje të mykut, si rezultat i lagështirës së tepërt. Pastroni dhe dezinfektoni të gjitha grilat mbrojtëse të sistemit të ajrimit.

**3.7 Përdorimi i ashensorëve**

Përdorimi i ashensorëve duhet të jetë i tillë që të lejojë respektimin e distancës së miratuar nga MSHMS-ja. Distanca mund të reduktohet për njerëzit që janë pjesë e së njëjtës familje ose që ndajnë një dhomë. Në raste të tjera, nuk rekomandohet përdorimi në të njëjtën kohë i ashensorit nga persona që nuk janë të së njëjtës familje. Butonat e ashensorit duhet të pastrohen periodikisht.

**3.8 Manual për administrimin e ushqimit dhe të pijeve**

- Kryeni larjen e duarve shpesh dhe sipas kërkesës.

- Vishni maskë dhe doreza kur përgatisni ose përdorni ushqimin.

- Shmangni pirjen e duhanit, ruani etiketën respiratore në ambientet ku përgatitet ose shërbehet ushqim.

- Ndalohet përgatitja ose prekja e ushqimeve, prekja e sipërfaqeve në kontakt me ushqimin pa pasur doreza.

- Ndalohet shijimi i ushqimit me gishta.

- Ndalohet prekja e flokëve ose e pjesëve të tjera të trupit pa doreza, kur ndodheni brenda zonave të përgatitjes apo të servirjes së ushqimit, pasi mund të rezultojnë në ndotje të ushqimit.

**- Menaxhimi i sipërmarrjes turistike duhet të promovojë sigurinë dhe higjienën e ushqimit për personat që përgatisin dhe shpërndajnë ushqimin.**

**3.9 Manual për shërbimin e mishit**

- Ndani mishin e papjekur nga ushqimet e tjera.

- Ndani mishin e papërpunuar, shpendët, ushqimet e detit dhe vezët nga ushqime të tjera në vendet e ruajtjes së përkohshme, kontejnerë ushqimorë apo frigoriferë.

- Përdorni një dërrasë prerëse për produkte të freskëta dhe një të veçantë për mish të papjekur, shpendë dhe ushqime deti.

- Asnjëherë mos vendosni ushqim të gatuar në një pjatë që keni vendosur më parë mish të papjekur, shpendë deti, ushqime deti ose vezë.

- Mos përdorni përsëri salcat marinuese të përdorura një herë për ushqime të papërpunuara.

**3.10 Higjiena e ushqimit në tërësi**

Ushqimet duhet të furnizohen nga burimet të sigurta dhe të transferohet në zonat e magazinimit. Furnizuesit dhe marrësit në dorëzim duhet të jenë të pajisur me maska dhe me doreza.

Parandaloni ndotjen e tërthortë midis ushqimit të papërpunuar dhe atij të përgatitur për konsum, duke përdorur një trajtim të veçantë për përgatitjen dhe për ruajtjen. Ushqimi, gjithashtu, duhet të mbrohet siç duhet gjatë ruajtjes dhe servirjes, për të parandaluar ndotjen me pajisje, vegla dhe personel, pasi transferimi i baktereve nga një ushqim (zakonisht i papërpunuar) në një tjetër është një nga shkaqet kryesore të sëmundjeve infektive që vijnë nga ushqimi.

Ushqimi i përpunuar, rekomandohet të gatuhet mirë para konsumimit.

Rekomandohet që në ambientet e gatimit, ventilimi të jetë në nivel shumë të mirë.

Në ambientet e gatimit të ketë sapun të lëngshëm, dezinfektant dhe peshqirë letre, për të mundësuar larjen e shpeshtë të duarve nga personeli që punon atje.

Siguroni kontejnerë të përshtatshëm të mbeturinave, të mbuluar dhe që duhen të pastrohen dy herë në ditë.

Sipërfaqet e kontaktit me ushqim të pajisjeve dhe të veglave duhet të mirëmbahen siç duhet, të mbahen të pastra dhe të higjienizohen ndërmjet përdorimeve.

Sipërfaqet e kontaktit të pajisjeve duhet të mirëmbahen të pastra.

**4.1 Rregulla për shërbimin në bare dhe në restorante**

Vendosja e tavolinave në restorante dhe në bare

Tavolinat duhet të vendosen në atë mënyrë që distanca nga pjesa e pasme e një karrigeje në pjesën e pasme të një karrigeje tjetër të jetë më shumë se 1 m larg dhe që klientët të përballen me njëri-tjetrin nga një distancë prej të paktën 1 m.




Personeli qe shërben ushqimin duhet të jetë i pajisur përgjatë gjithë periudhës së shërbimit me maska dhe dorashka të higjienizuara.

Në rastin e ofrimit të shërbimit bufe, administratori/menaxheri i strukturave akomoduese të kapaciteteve të mëdha (hotel/resort) rekomandohet të përcaktojë dhe të shënojë dukshëm korridorin e lëvizjes së klientëve.

Klientët rekomandohet të respektojnë distancën e rekomanduar nga Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në rast se përdoren makinat automatike, pijet të shërbehen vetëm në gota kartoni njëpërdorimëshe.

Pjesët e makinerive në kontakt me duart e përdoruesit, rekomandohet të pastrohen dhe dezinfektohen të paktën pas çdo shërbimi dhe më shpesh nëse është e nevojshme.

**4.2 Larja e enëve, lugëve, pirunëve, thikave dhe pecetave të tavolinës**

Të gjitha enët, lugët, pirunët, thikat, gotat duhet të lahen dhe dezinfektohen në një makinë larëse enësh, duke përfshirë sendet që nuk janë përdorur, pasi ato mund të kenë qenë në kontakt me duart e klientëve ose të punonjësve.

Nëse për ndonjë arsye kërkohet larje manuale, duhet të ndiqen hapat e zakonshëm (larja, dezinfektimi, shpëlarja), duke marrë nivelin maksimal të masave paraprake. Tharja duhet të

bëhet duke përdorur peshqir letre të disponueshëm.

Po kështu, mbulesat e tavolinave dhe të pecetave duhet të lahen në mënyrën e zakonshme dhe të hekurosen.

**4.3 Informacion dhe komunikim**

Punonjësit e restoranteve dhe të bareve duhet të njihen dhe të zbatojnë me rreptësi rregullat e higjienës personale të vendosura nga MSHMS-ja. Po kështu, klientët duhet të drejtohen kur hyjnë dhe dalin nga restoranti apo bari për të dezinfektuar duart e tyre me xhel dezinfektues, që duhet vendosur në hyrje të këtyre ambienteve. Klientët duhet të ruajnë distancën e miratuar nga MSHMS-ja midis tyre (1.5 metra).

**5. Rregulla për shërbimin në plazhe**

**5.1 Rregulla të përgjithshme**

Deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-19, të gjitha stacionet e plazhit, si dhe plazhet publike duhet të kenë të afishuara këshillat dhe rregullat në kuadër të mbrojtjes nga COVID-19.

Këto rregulla konsistojnë, në:

Mbani parasysh rregullat bazë për parandalimin e COVID-19:

a) lani dhe dezinfektoni duart, vazhdimisht dhe në mënyrën e duhur;

b) përdorni maskat sipas udhëzimeve;

c) shmangni grumbullimet në njerëz dhe çdo lloj kontakti;

d) mos prekni fytyrën dhe hundët me duar të palara e të padezinfektuara;

e) kur kolliteni ose teshtini, mbulojeni gojën/hundën me parakrah ose me facoleta njëpërdorimëshe;

f) nëse vini re simptomat e COVID-19, telefononi nr. 127.

Në marrjen e shërbimeve në ambientet e stacionit të plazhit, respektoni gjithmonë, sipas masave të miratuara të MSHMS-së (1.5 m).

Ruani gjithmonë distancën edhe gjatë shëtitjeve në plazhe, bregun e detit, liqenit, lumit apo përgjatë shëtitoreve.

**5.2 Shërbimet në stacionet e plazhit**

Stafi që shërben pranë stacioneve të plazhit të ketë uniformë dalluese.

Shërbimi për pastrimin dhe mirëmbajtjen e stacionit të plazhit dhe të gjitha ambienteve të tjera të jetë ditore.

Të kryhet dezinfektimi i krevateve të plazhit, shërbimeve higjienike dhe aksesorëve të ndryshëm në mënyrë periodike; gjatë orarit të hapjes së stacionit të plazhit duhet të sigurohet vazhdimësia e pastërtisë dhe boshatisja e koshave të mbeturinave.

Të gjitha aktivitetet (si bare, *beach*-bare) duhet të jenë në përputhje me direktivat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

**5.3 Brezi i shërbimeve dhe distancat që duhen respektuar**

Deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-19, brenda brezit të shërbimeve në stacionet e plazhit, mund të realizohen këto struktura: kioskë menaxhimi për plazhin, kabina, shërbime higjienike, depo, pika vrojtimi/kulla e vrojtimit, hapësirë për rojën e plazhit (në rastin e plazhit publik), *beach*-bar, hapësirë për vendosjen e biçikletave.

Tavolinat në *beach*-bar duhet të kenë distancë, sipas udhëzimeve të MSHMS-së.

Deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-19, kushtet minimale që duhet të përmbushë një stacion plazhi, në plazhet e tipit A, janë si më poshtë vijojnë:

a) për çadrat dhe ndenjëset e pushuesve të respektohet një distancë prej të paktën 7 m nga vija e bregut të detit, liqenit, lumit;

b) hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) nuk duhet të jetë më e vogël se 3.5 m në linjë horizontale me vijën e ujit, si dhe jo më e vogël se 3.5 m në linjë vertikale me vijën e ujit;

c) të ketë në dispozicion të pushuesve 1 dush me ujë të ëmbël për çdo 100 (njëqind) çadra, i cili duhet të pajiset me sapun, xhel higjienizues;

d) të gjitha kushtet e tjera, përveç sa më sipër, të përcaktuara nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 27.3.2019, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit'".

Kushtet minimale, që duhet të plotësojë një stacion plazhi, në plazhet e tipit B, janë si më poshtë vijon:

a) hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) duhet të jetë të paktën 3.5 m;

b) të ketë në dispozicion të pushuesve 1 (një) dush me ujë të ëmbël për çdo 100 (njëqind) çadra, i cili duhet të pajiset me sapun, xhel higjienizues;

c) të gjitha kushtet e tjera, përveç sa më sipër, të përcaktuara nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 27.3.2019, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit"'.







RREGULLORE PER STACIONET E PLAZHIT
PLAZHI TIPI A
SIPERFAQE 200 M2
SINJALIZIMI ME BOVA
NE NGJYRE TE KUQE
TE HAPESIRES SE DEDIKUAR
PER NOT 200 M
SINJALIZIMI ME BOVA ME NGJYRE TE BARDHE
TE HAPESIRES SE SIGURT PER NOT
DERI NE THELLESINE 1.6 M
DISTANCA MBI 3 METRA
MIDIS PUSHUESVE
KULLE VROJTIMI 3 M ME TENDE TE KUQE
KU SHKRUHET : VROJTUES PLAZHI / LIFEGUARD
TE AFISHOHEN NR. E TELEFONIT TE
ORGANEVE POLICIA E SHTETIT DHE POLICIA KUFITARE
ZJARREFIKESIT, KATHEDRA DE TAKE
OBJEKTA KOMERCIALE TE LOCIONALE OPERACIONALE DETARE
TE AFISHOHEN NESHTILAT DHE JITAR PUSHUESVE
1 VROJTUES PLAZHI DUHET TE MBULOJE 80 ML
FLAMUR NE SHKOP 3.5 M
NE PERPUTHJE ME KUSHTET E MOTIT
SI DHE NJE TABELE SQARUESE
NE SHQIP DHE ANGLISHT
20% E SIPERFAQES SE
PLAZHIT
ESHTE PUBLIKE
TABELE INFORMUESE
NE KUADER TE COVID-19
ZONA E NDIHMES
SE SHPEJTE
SHERBIMIE HIGJENIKE :
2 PER CDO 100 CADRA
1 PER FEMRA
1 PER MESHKUJ
KABINA ZHVESHJE
2 CDO 50 CADRA
1 PER FEMRA
1 PER MESHKUJ
KOSH
MBETURINASH
1 DUSH
CDO 100 CADRA.
TABELA REKLAMUESE
TE IDENTITETIT TE SUBJEKTIT
SI DHE CMIMEVE TE OFRUARA
10 m
2.5 m
3.5 m
6 m


RREGULLORE PER STACIONET E PLAZHIT
PLAZHI TIPI B
SIPERFAQE 200 M2

**5.4 Këndi për fëmijë**

Këndet e fëmijëve, në ambientet e hapura (deri në një urdhër të dytë të MSHMS-së për funksionimin e këndeve të lojërave në ambientet e mbyllura) do të funksionojnë sipas rregullave të distancimit fizik dhe të masave higjieno-sanitare (urdhër nr. 351, datë 29.5.2020).

**5.5 Zona e pishinës**

Pavarësisht përfshirjes në këtë protokoll, mbështetur në urdhrin nr. 351, datë 29.5.2020, të gjitha pishinat janë të mbyllura deri në një urdhër të dytë.

Uji i pishinës duhet të pastrohet nga qarkullimi përmes një sistemi filtrimi të detyrueshëm.

Duhet të largohen rregullisht papastërtitë e dukshme në sipërfaqe të ujit.

E gjithë zona dhe të gjitha objektet e pishinës dhe të banjave duhet të pastrohen dhe të dezinfektohen të paktën një herë në ditë, por dhe më shpesh, nëse fluksi i klientëve është i lartë.

Klorinimi i ujit të bëhet rregullisht sipas standardeve.

Shezlonget e pishinës duhet të jenë me distancë të paktën 2 metra larg nga njëri grup tek tjetri. Hoteli duhet të sigurojë materiale dezinfektuese në zonën e pishinës për të lejuar punonjësit e pishinave dhe klientët të pastrojnë shezlonget.

Pishina të ketë kosha dhe peshqirë letre.

Punonjësi i pishinës duhet të dezinfektojë shtresat e shezlongeve dhe krahët mbështetëse.

**6. SPA/sauna/masazh dhe qendër bukurie**

- Të kryhet rregullisht mbas çdo seance pastrimi i saunës përpara se të fillojë seanca tjetër.

- Të gjitha muret, dyshemetë duhet të mirëmbahen në një gjendje të pastër dhe duhet të pastrohen periodikisht.

- Sipërfaqja e shtratit të masazhit duhet të jetë prej plastike të qëndrueshme për larje ose material tjetër i papërshkueshëm nga uji, i cili është i lehtë për pastrim, dezinfektim dhe mirëmbajtje.

- Sipërfaqja e shtratit të masazhit duhet të dezinfektohet dhe më pas të shpëlahet me ujë dhe të thahet pas çdo përdorimi.

- Mbulesa letre me një përdorim duhet të hidhen në një kosh pas përdorimit.

- Nëse për klientët sigurohen veshje, ato duhet të vendosen në qese plastike të sigurta dhe t'i nënshtrohen procesit të duhur të pastrimit pas çdo përdorimi.

- Bazuar në madhësinë e ambientit, hoteli/ resorti mund të lejojë një numër maksimal të klientëve në të njëjtën kohë në zonën SPA, duke respektuar distancën 1.5 metra midis tyre.

- Për klientët që dëshirojnë të shijojnë një masazh apo të përdorin sauna apo jakuzi, çdonjëri prej tyre duhet të bëjë një rezervim, në mënyrë që të kontrollohet numri i tyre në respekt të distancës 1.5 metra.

- Materialet e dezinfektimit duhet të jenë të disponueshme përreth zonës SPA.

**7. Organizimi i konferencave MICE/ eventeve**

Lejimi i konferencave, eventeve, trajnimeve, seminareve, takimeve etj., në rast të përmbushjes së kritereve për hapësirat rekomandohet të zhvillohen:

- zhvillimi i konferencave/eventeve, aty ku është e mundur, në sallat që mund të lejojnë distancimin fizik;

- rekomandohet që ulja e pjesëmarrësve të jetë e tillë që të respektojë protokollet e aprovuara nga MSHMS-ja.



**8. Rregulla për guidat dhe ekskursionet**

Rekomandime për vizitat në muze, site kulturore, arkeologjike dhe zona të mbrojtura, për grupe të organizuara, familje apo individë:

1. Rekomandohet ruajtja e distancave fizike dhe higjienës personale, sipas udhëzimeve të MSHMS-së.

2. Në muze, site kulturore, arkeologjike dhe zona të mbrojtura vendosen kosha të posaçëm për depozitimin e mbetjeve anti-COVID.

3. Në fillim të çdo udhëtimi, guida turistike rekomandohet t'u japë informacionin e nevojshëm turistëve për ruajtjen e distancës fizike dhe të higjienës, sipas udhëzimeve të MSHMS-së.

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 308 lekë